

ISMAIL KADARE

*Përballë pasqyrës
së një gruaje*

BIBLIOTEKA

85H-31

K 14

Tre romane të shkurtër



Onufri


85H-31

K 14

Ismail Kadare

PËRBALLË PASQYRËS
SË NJË GRUAJE

Tre romane të shkurtër



Onufri

1

Më 7 prill 1939, në orën 6 të mëngjesit, tabloja “*Kalorësi me skifter*” ishte varur në muzeun e një vendi skandinav. Rreth dy mijë kilometra më larg, në një qytet të Italisë Qendrore, arkitekti Ernesto Mohr, pas një nate plot dyshime, për shkak të dhimbjeve në shpretkë, po bënte një gjumë të rëndë plumb. Diku më në lindje, në anën tjetër të detit Adriatik, djaloshi 17 vjeçar shqiptar Bardh Beltoja, nxënës i liceut klasik, flinte gjithashtu në banesën 27, Rruga mbretërore, në qytetin e Durrësit. Një avion ushtarak fluturonte gjatë bregdetit shqiptar, midis Durrësit dhe Shëngjinit. Që nga dritarja e tij, ministri i Jashtëm italian, konti Çiano, që e ngiste vetë avionin, vështronte me vëmendje vijën e bregut të mbuluar me pyllishte dhe kënetë. Vend i hatashëm për një banesë gjuetie, tha me vete. Një banesë me shumë dhoma fjetjeje, me darka me pishtarë, dhe miqtë që mbërrinin njëri pas tjetrit nga larg. E përfytyroi anën e djathtë të vitheve të lëmuara të baroneshës Scorza, me surprizën e fundit, një tatuazh të vogël të bërë enkas për të, një akrep me

thumbin e ngritur përjetë, dhe buzëqeshi. Pastaj e ktheu avionin nga e djathta, si për t' u siguruar se anijet e luftës, që së shpejti do të zbarkonin në Shqipëri, ishin poshtë tij.

Ashtu si shumë qenie e sende lidheshin e çlidheshin shpesh në këtë botë, piktura mesjetare e muzeut skandinav, arkitekti i sëmurë nga shpretkë, konti Çiano dhe djaloshi shqiptar Bardh Beltoja, u lidhën befas në atë mëngjes të kthjellët të 7 prillit, me një fije të padukshme, nga ato që mund të thurte vetëm mortja.

Nyja do të zgjidhej brenda 7 vjetësh.

2

Ndërtimi i asaj që do të quhej më pas “Gjuetina e Lezhës” nisi në tetor të po atij viti. Në fillim të 1940-ës, ndërtesa po dilte nga themelet. Ajo ngjante e ftohtë: gjysmë manastir, gjysmë kullë malësore shqiptare, një gërshetim që për shumëkënd dukej i pamundur.

Në pranverë dhe gjatë verës, arkitekti Mohr bëri dy udhëtime në Shqipëri, për të mbikqyrur punimet. Fluturimi me avion, në vend që t' ia ngucte, për çudi ia qetësonte dhimbjet e shpretkës.

I zgjodhi vetë gurët, sidomos ata që do

gdhendeshin për hyrjen dhe vatrat, gurë të vjetër, lakuriqësia e të cilëve dukej se ua shtonte madhësinë dhe heshtjen. Ishte një madhështi e drojtur, si e një bote tjetër, që ruante përherë një mosafirim dhe mister, të cilën konti megjithatë e pëlqente.

Dërrasat me të cilat do të visheshin muret dhe qiellzanat, u nxorën gjithashtu nga pyjet përreth. Zymtinë që gurët e nxirrnin kursyeshëm ato e shpallën më hapur, çka edhe vetëkuptohej. Por kontit edhe kjo i pëlqente.

3

Udhëtimin e tretë dhe të fundit arkitekti e bëri në vjeshtë. Konti ngutej. Pas mbikqyrjes shpejt e shpejt të pajisjeve të brendshme, arkitekti bëri vërejtjet e fundit. Nga modelet e ndenjseve zgjodhi ato më të thjeshtat, ca si frona me shpinë, që malësorët shqiptarë i quanin “shkamb”, ngaqë më shumë se ndenjseve iu ngjanin vërtet gurëve të rastit, mbi të cilët shtegtari ulet për të pushuar. Te të gjitha vatrat, madje edhe te vatra e madhe, hoqi çdo shenjë që të kujtonte mermerin, me synimin që të mos prekej “karakterin tragjik” i vatrës ballkanase. Prej mbulesave zgjodhi

kryesisht ato me lesh deleje, që vinin, sipas tij, drejt e nga kohërat homerike. Pasqyrat i ktheu të gjitha mbrapsht, përveç atyre të banjave. Janë të pakëshillueshme pasqyrat ndanë një kënete, tha pa vështruar askënd. Shoqëruesit e kontit pritën që ai t'u kërkonte sqarime për atë frazë misterioze, por tjetri heshti. Jo vetëm kaq, nga buzëqeshja disi e largët mbi fytyrën e tij, dukej se arkitekti kishte shprehur prapë diçka që, sipas kontit, dëshmonte një ndërkuptim të tyre të brendshëm, për të cilin fshehtas ai ishte krenar.

Megjithatë, gjatë kapërcimit të oborrit të brendshëm, duke përfituar që arkitekti ndodhej më larg, ndihmësi i pëshpëriti Çianos se, pavarësisht se e çmonte arkitektin, lidhur me mendimin e tij se “tragjizmi i një vatre ballkanase” kushtëzohej nga bisedat që bëheshin pranë saj, biseda dramatike, shpeshherë kuvendime morti etj., ai dëshironte t'i kujtonte zotit kont se këtu nuk bëhej fjalë për një dhomë malësorësh shqiptarë, por për një *séjour* ku do të mblidheshin të ftuarit e zotit kont, domethënë, ajka e aristokracisë së përtejdetit...

Ndërsa tjetri fliste, mendjen e Çianos e përshkoi vetëtimshëm mendimi se nuk kishte gjë më përndezëse se kundërtia midis gurëve të ftohtë e zymtorë të një mjedisi dhe mëndafshit të të brendshmeve të grave, të ardhura nga larg për dashuri. Tani i pëlqente të mendonte se arkitekti, duke ia kuptuar këtë xanxë të tij të fshehtë, ndërsa bënte sikur e akullonte mjedisin,

duke dhënë përshtypjen se gjithçka mund të kryhej këtu, veç dashurisë, në të vërtetë sajonte të kundërtën.

Çiano nuk iu përgjigj ndihmësit. Ndodheshin ndërkaq te salla kryesore, ajo e darkave. Arkitekti i pa me radhë shandanët që do të vendoseshin në mure, shandanë bakri e hekuri të rrahur, të ngjashëm me ata të hyrjes kryesore, të cilët u ngjanin atyre të bujtinave (të bujtinave mesjetare nëpër udhë plot rrezik, sipas shprehjes së arkitektit).

Ai bëri më pak vërejtje se ç'pritej për shandanët, ngaqë dukej se mendjen e kishte në tjetër gjë.

- Këtu duhet një tablo, - tha duke qëndruar me duar të kryqëzuara te muri përballë vatrës. - E vetmja pikturë në këtë sallë.

Të tjerët e vështruan me ca sy që dukej sikur thoshin: të shohim tani se ç'perlë a ç'prapësi do të na nxjerrë.

Ndërsa prisnin që ai të shqiptonte emrin e tablosë a të piktorit, arkitekti, për habinë e tyre, u duk se për herë të parë e humbi sigurinë. Shkakun e kapën shumë shpejt. Emrin e piktorit e të tablosë, të tablosë së vetme që mund të vendosej në atë mur, ai nuk e mbante mend mirë. Kishte mundësi që të ishte e Rembrandit ose e Rubensit, ose e ndonjë bashkëkohësi të tyre. Kishte gjasë që të quhej "Kalorësi me skifter", por as për këtë nuk ishte i sigurt. E kishte parë vite më parë, në rininë e tij, në muzeun e një qyteti skandinav, emrin e të cilit gjithashtu nuk e kujtonte dot. E vetmja gjë e

sigurt ishte se ishte qytet e jo kryeqytet. Sa për tablonë... në të ishte pikturuar një kalorës që mbante në dorë një skifter gjahu... Kalorësi është ftuar në një gjah... Fytyra e tij ka një shprehje misterioze, që mund të shkoqitet në gjithfarë mënyrash... Pra, me sa më kujtohet, ai... do të shkojë në atë gjah... megjithatë fytyra e tij është plot enigmë...

- Në këtë mur unë s'mund të përfytyroj asnjë tablo tjetër, - vazhdoi arkitekti. - Është piktura e të ftuarit në gjah, më kuptoni, zoti kont? Është thelbi i gjithçkaje. Dhe dyshimi dhe misteri në fytyrën e tij, është misteri i gjithkujt që vjen nga larg, që bujt, qoftë njeri, apo hije... Në fund të fundit, ne nuk mund ta dimë kurrë se ç'ka në kokë ai që vjen...

Ç'mrekulli, tha me vete konti.

Arkitekti mori frymë thellë, përpara se të mbaronte mendimin e tij. Zoti kont kishte të gjitha mjetet për ta gjetur atë tablo. Kishte ambasada, informatorë në ato vende. Në mos nuk e blente pikturën, të nxirrte prej saj një riprodhim prej dorës së një piktori. Kjo ishte dëshira e tij. Dhe tani, me lejen e zotit kont, ai do të donte të pushonte pak. Shpretkë po i dhimbte më fort se kurrë.

- Pushoni, i dashur, pushoni, - i tha Çiano, duke i vënë dorën miqësisht në sup. - Dëshira juaj do të kryhet. Ju jap fjalën.

Arkitekti falenderoi me krye. Ishte krejt i zbehtë në fytyrë.

Pajisja e dhomave të fjetjes, e fill pas tyre ajo e mjediseve të tjera, bashkë me provën e tymtarëve, u krye brenda tri javësh.

Në fillim të dhjetorit gjithçka ishte gati. Punë të papritura të shtetit e penguan Çianon të vinte vetë, për t'i hedhur një vrojtim të fundit atij që në rrethet mondane e quanin tani "trilli shqiptar" ose "marrëzia shqiptare" e kontit.

I dërguari i tij e kqyri gjithçka me përkushtim, që nga velenxat prej leshi të bardhë të apartamentit vetiak të kontit, gjer te fenerët e molit të vogël prej druri, atje ku do të lidheshin barkat.

Ftesat për gjahun e parë ishin shpërndarë qyshkur dhe në Romën, që kishte ndërkaq dy vjet, që quhej kryeqyteti i mbretërisë së bashkuar të Italisë, Etiopisë e Shqipërisë, kishin nisur ndërkaq qejfmbetjet e pashmangshme në kësi rastesh.

Ndryshe nga ç'e kishte parashikuar në fillim, konti mbërriti vetëm disa orë përpara se të arrinin të ftuarit e parë. Në vend që të bënte një mbikqyrje të fundit, siç pritej, ai tha se do të pushonte pak. E vetmja gjë që kërkoi të shihte ishte tabloja, që kishte mbërritur veç dy ditë më parë nga Skandinavia.

Qëndroi një copë herë të gjatë përpara saj në këmbë, pa lëvizur. Lodrimi i flakëve të vatrës së madhe,

që ndodhej përballë pikturës, dukej se arrinte herë pas here gjer te ajo. Ishte një rastësi ajo pjesëmarrje e vatrës në ndriçimin e fytyrës së kalorësit të pikturuar, apo gjithçka ishte parashikuar në mënyrën më gjeniale?

Diçka i shpëtonte në shprehjen e fytyrës së njeriut të ftuar për gjah. Përndritja e dobësuar e zjarrit, herë e shtonte, herë e fikte misterin e saj.

Mëkat që arkitekti nuk do të vinte. Dergjej qysh prej tri javësh në shtratin prej nga, me sa dukej, nuk do të ngrihej më. Dergja e tjetrit, e lidhur me mosshpjegimin prej tij të pikturës, u përzie me njoftimet që kishin shoqëruar riprodhimin e saj. Ishte një kalorës që, me sa dukej, po thirrej për herë të fundit në një gjah. Sytë e tij e shprehnin pothuajse hapur atë dyshim.

Konti e ndjente se gjendej në njërin nga ato çaste të rralla kur ndihej i aftë t' i afrohej kuptimit të fshehtë të artit. Sytë e kalorësit kishin vërtet një dyshim, por ai ishte i mpirë, i fisnikëruar nga trishtimi dhe fataliteti. Ai sapo kishte marrë ftesën për gjah dhe, ndonëse dyshonte se atje... në gjah... mund ta pësonte..., do të shkonte, megjithatë..., drejt fatit të tij...

Jo, tha me vete konti, njëlloj si atë ditë kur e kishte lexuar për herë të parë atë shpjegim. Këto histori mesjetare nuk ndodhnin më. Ai ishte i larë përpara Zotit: kurrë nuk i kishte shkuar ndër mend të ftonte dikë si në kurth...

Jo, tha prapë me vete, dhe aty për aty ndjeu prapë